

---

## RAPORT VLERËSUES

### MBI RESPEKTIMIN E TË DREJTAVE TË GRAVE NË MEDIAN LOKALE PËR ELBASANIN DHE KORÇËN

---



Ky raport u realizua në kuadër të projektit “Fuqizimi i grave dhe vajzave në media” në qarkun e Elbasanit dhe Korçës e mbështetur financiarisht nga Mediterranean Womens Fund dhe e zbatuar nga INAC (Information NetWork & Active Citizenship)

Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e Rrjetit të Informimit dhe Qytetarisë Aktive dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet Mediteranean Womens Korrik 2023



## **Rëndësia e medias**

Sipas René Marcic, filozof dhe publicist austriak, “bartësi i vetëm legjitim i një “pushteti të katërt” në shtetin kushtetues demokratik është publiku, tërësia e të gjithë qytetarëve, e formuar në një proces të përhershëm komunikimi dhe informimi përmes medias, e cila funksionon si organ kontrolli për pushtetin shtetëror”. Media është pjesë e këtij kontrolli vetëm në masën që ajo ndikon krijimin dhe mbarëvajtjen e këtij procesi të komunikimi shoqëror.

Aftësia e saj për të krijuar lëvizje shoqërore, për të transmetuar informacion, për të promovuar organizata dhe kultura është gjithmonë një proces kompleks që duhet studiuar në vazhdimësi.

Media është një mjet komunikimi tepër i rëndësishëm. Në ditët e sotme, ku interneti ka hyrë në çdo familje dhe rrjetet sociale u japin mundësi të gjithëve që të thonë opinionin e tyre, aftësitë e gazetarëve për të dhënë lajmin e saktë marrin akoma më shumë vlerë.<sup>1</sup>

## **Roli i medias në barazinë gjinore**

Nocioni i Medias është shumë më i gjerë se sa ai i gazetarisë. Televizioni, radioja, gazetat dhe interneti prodhojnë çdo ditë mijëra tekste dhe imazhe, që përbëjnë një nga pikat themelore të referimit për botën e sotme për miliona njerëz kudo ku ata jetojnë. Posterat kanë pushtuar hapësirat tona publike dhe industria e reklamave na propozon çdo ditë produkte të reja nëpërmjet Medias. Çështja është si paraqitet kjo botë në këtë shumësi informacioni që na vjen nga të katër anët.<sup>2</sup> Si ndikon ndarja e këtij informacioni? A është një informacion që ka në qendër barazinë dhe dhënien e mundësive për gjinitë apo ka një ndikim të ndjeshëm të njëjës gjini në varësi të çështjeve që trajtohen. Sigurisht që përpjekjet për trajtim të barabartë nuk mungojnë por në

---

<sup>1</sup> <https://balkansmedia.org/sq/korisni-savjeti-i-alati/cfare-eshte-rendesia-e-mediave-gjitheperفشirese-dhe-jemi-te-vetedijshem>

<sup>2</sup> [https://www.gadc.org.al/media/files/upload/MEDIA\\_DHE\\_BARAZIA\\_GJINORE.pdf](https://www.gadc.org.al/media/files/upload/MEDIA_DHE_BARAZIA_GJINORE.pdf)

*Raport Vlerësues: Mbi respektimin e të drejtave të grave në median lokale për Elbasanin dhe Korçën*



varësi të zhvillimit, të botkuptimit, të qeverisjes, të emancipimit shoqëror janë edhe këto përpjekje për të siguruar barazi mundësish, barazi të gjinive dhe luftën ndaj stereotipeve gjinore.

Nëse media ka synimin që të krijojë kushte të tilla të barazisë dhe bën përpjekje të rëndësishme atëherë edhe publiku do të ketë më shumë mundësi të edukohet nëpërmjet medias për të respektuar gjinitë në bazë të aftësive dhe veçorive duke mos diskriminuar dhe duke mos krijuar stereotipe që favorizojnë apo dizavantazhojnë një gjini të caktuar.

## Metodologjia

Në raportin studimor janë përfshirë 13 gazetarë që punojnë pranë mediave lokale dhe kombëtare në qarkun e Elbasanit dhe të Korçës. Një pjesë e tyre kanë një provojë pune të gjatë, por ka edhe gazetarë të rinj të cilët po integrohen në tregun e punës në këto zona.

Për të bërë një raport studimor mbi: Respektimin e të drejtave të grave në median lokale për Elbasanin dhe Korçën u realizua një pyetësor i cili u plotësua nga 13 gazetarë në të dy qarqet. Qëllimi i pyetësorit ishte që problematika të kuptohej më mire dhe të identifikohesh situata në respektimin e të drejtave me bazë gjininë. Pyetësori u realizua me pyetje të hapura dhe të mbyllura me qëllim që gazetarët të shprehnin edhe mendimin e tyre. Gjinia, e cila mori pjesë në pyetësor ishin gra dhe vajza. Pjesa më e madhe e të përfshirë në pyetësor ishte të moshave ndërmjet 30-40 vjeç.

Gazetarët që morën pjesë:


Gjinia	Femra	13	100%
	Meshkuj	0	0%
Moshë	20-30 vjeç	2	15.4%
	30-40 vjeç	4	30.8%
	40-50 vjeç	7	53.8%



## Gjetjet

Gazetarëve, të cilët morën pjesë në këtë vëzhgim me qëllim: Respektimin e të drejtave të grave në median lokale për Elbasanin dhe Korçën, i'u drejtuan pyetje të ndryshme lidhur me punën e tyre, barazin gjinore në media, a kanë përjetuar diskriminim gjinor në punë, çfarë mund të bëjmë për të inkurajuar ndryshime pozitive në lidhje me përfaqësimin e ulët të grave në rolet vendimarrëse në media, etj.

Gazetarët u pyetën edhe për vendbanimin e tyre, i cili rezultoi se 6 (46.2%) gazetarë banonin në Elbasan 6(46.2%) gazetarë banonin në Korçë dhe 1 (7.7%) jeton në Pogradec.



Roli i grave në media duket një çështje që kërkon një vëmendje të shtuar për vetë rëndësinë dhe ndikimin që ka në komunikimin me publikun. Për ta kuptuar më mirë nëse ato ndjenin paragjykim në punën e tyre i pyetëm se çfarë kuptojnë me barazi gjinore në media. “Media është një shkollë e dytë ku nëpërmjet emisioneve, historive shpaloset bota e një femre. Gazetarët janë përçues të lajmit, dhe po ashtu i lind detyra të informojnë, mbështesin dhe inspirojnë çdo femër që mendon se nuk mundet dhe nuk ka hapësirat e duhura në shoqërinë që jetojnë” thotë një prej gazetarëve, që plotësuan pyetësin.

*Raport Vlerësues: Mbi respektimin e të drejtave të grave në median lokale për Elbasanin dhe Korçën*



Më poshtë disa përkufizime për barazinë gjinore në media:

Të jesh e lirë dhe e barabartë, të mundesh të shkruash atë që mendon dhe të gjesh mbështetje nga të gjithë.

Gazetaria M.S

Barazia gjinore nënkupton barazinë e burrave, grave dhe personave me identitete të ndryshme gjinore në jetën shoqërore dhe politike.

Gazetaria I.SH

Barazia gjinore fillon me emancipimin e femrës dhe me rolin që ajo ka në jetën publike, artistike, mediatike, drejtuese etj. Profesionet nuk ndahen në varësi të gjinisë por sipas aftësive. Roli i gruas në media është emancipim, zhvillim, feminilitet. Ende flasim për dhunë e masakra ku rastet jepen në media, kronika. Zëri i gruas duhet të dalë të ndalojë cdo aspekt dhune fizike e psikologjike. Shkollimi është një ndër mënyrat për të arritur sukses, por edhe historitë e denoncimet janë sukses më vete.

Gazetaria S.h

Barazia gjinore në media dhe më gjërë e kuptoj si krijimin e mundësive për karrierë, ashtu si gjinia tjetër, hapsirave për ushtrimin e profesionit pa u diskutuar për shkak të gjinisë, trajtimit financiar mbi meritokracinë dhe vlerësimin.

Gazetaria D.Z

Gazetaret, që u përfshinë në pyetësor, u pyetën se pse është e rëndësishme përfshirja e sa më shumë grave në media, duke qënë se numri i vajzave dhe grave në media është rritur kohët e fundit në median e shkruar (online) dhe vizive. Gazetaret e përfshira në pyetësor u shprehën se :

Nëse e do diçka e arrin asgjë nuk mund të jetë e pamundur. Sot femrat kanë mundësi të

*Raport Vlerësues: Mbi respektimin e të drejtave të grave në median lokale për Elbasanin dhe Korçën*



shpalosin pasionin dhe duke punuar për tu kthyer në profesioniste të zonjat. Media është një mundësi ku përvec shpalosjes së aftësive femrat të ngrihen në hierarki duke u shfaqur në sferën publike dhe kjo është inkurajimin për gratë të cilat shohin lajme, emisione apo dokumentave, sepse gratë kanë aftësi më të mira drejtuese.

Gazetare E.D

Përfshirja e vajzave dhe grave në media unë e shoh në aspektin cilësor më tepër se atë sasior dhe rritja e numrit të tyre jo domosdoshmërisht nënkupton cilësi dhe standarte profesionale apo integritet. Media sot ka nevojë për profesionistët përtej statusit gjinor.

Gazetare E.A

Gratë kanë treguar se janë të afta dhe munden tja dalin në çdo fushë, edhe në median e shkruar edhe në atë vizive. Përfshirja e sa më shumë grave në media është e rëndësishme pasi krijon një përmbajtje më cilësore dhe të ndjeshme ndaj komunitetit.

Gazetare G.M

Duke qënë se diskriminimi ndjehet më shumë të vajzat dhe gratë të anketuarit u pyetën se a kishin ndier diskriminim në karrierën e tyre profesionale.

38.46% të pjesmarrësve të cilët iu përgjigjën pyetësorit pohuan që kishin ndjer diskriminim në karrierën e tyre profesionale. 53.85% e pjesmarrësve në puhuan se nuk kishin ndjerë vetë diskriminim në karrierën e tyre profesionale dhe 7.69% e tyre nuk preferuan te jepnin një përgjigje mbi pyetjen e berë.

Gazetaret u pyetën se a e kanë mjaftueshëm vëmëndjen çështjet gjinore në Shqipëri. Ku pjesa më e madhe e tyre është përgjigjur se nuk e kanë vëmëndjen e duhur.



Jo nuk mendoj se ka. Zëri i grave nevojitet në media pasi në këtë barazi gjinore që flitet që ekziston por realisht për mua është e padukshme.

Gazetare E.D

Vëmëndja ndaj çështjeve gjinore në vënd mbetet në kuadër të fushave të shoqërisë civile më së shumti, impakti i të cilave mbetet modest. Ndërkohë që institucionet dhe ligjvënësit janë fokusuar më tepër të zbatimi i garancive gjinore thjesht për të qënë në rregull dhe pa e parë këtë si aspekt thelbësor për mjedisin social-ekonomik të vendit.

Gazetare DH.C

Gazetaret u pyetën nëse do të krahasonin pengesat për gratë që punojnë në gazetari nga viti 2005 deri sot, si ka ndryshuar situata për mirë, për keq apo nuk ka ndryshuar aspak, të dhënat e mbledhura për këtë pyetje do të përmbledhim në një tabelë më poshtë.

Për mirë	8 Gazetare	61.5%
Për keq	1 Gazetare	7.7%
Nuk ka ndryshuar	4 Gazetare	30.8%

Gazetaret u pyetën se pse kemi pak gra dhe vajza në media dhe në pozicione drejtuese në Shqipëri? Mendimet e tyre të përmbledhura ishin se në Shqipëri nuk ka meritokraci, burrat janë më të korruptueshëm sesa gratë, por edhe ekzistojnë paragjykimet dhe stereotipet gjinore se vetëm urrat mund të udhëheqin dhe gratë jo.

Vijon ende mentaliteti i dikurshëm për gratë dhe vajzat, të cilat nuk janë të barabarta me burrat sepse shoqëria jonë maskiliste nuk është ende gati të pranojë idenë se edhe një grua mund të drejtojë.

Gazetare R.B



Femrat duken si një qenie e dobët ku forca e një mashkulli vendoset në mënyrë absolute me intelektin dhe aftësitë. Jemi një shoqëri maskiliste e cila në dukje duket e emancipuar.  
Gazetare S. XH

Spektori i medias reflekton thelbësisht konfigurimin patriakal të shoqërisë shqiptare, ku burrat dominojnë në postet drejtuese, aspak për aftësi më të mëdha ndaj grave. Grave u jepet më pak mundësia për karrierë.  
Gazetare B.N

Shtetet Antare të BE- së janë shqetësuar për pjesmarrjen e grave në vendimmarrje, pse kjo çështje nuk është adresuar asnjëherë në media? Gazetaret që plotësuan pyetësin u shprehën se media nuk ka luajtur rolin që i takon ndikuar nga politikat qeverisëse.

Media edhe pse quhet “ pushteti i katërt” është varur nga pushteti. Mediat gjithashtu përforcojnë rolet dhe hierarkitë gjinore duke mos i parapërgatitur gratë si të jenë plotësisht të pavarura jashtë marrëdhënies së tyre me burrat a familjet.

Nënshtrimi i tyre simbolik është sidomos i qartë në përshkrimet e politikanëve.  
Gazetare: M.S/ I.SH

Fuqia e medias e lejon këtë sepse një punonjës i medias duhet të jetë i lirë duke kërkuar të drejta informimi, duke folur në lidhje me padrejtësitë e duke investiguar. Pjesëmarrja e grave dhe vajzave në media duhet të ishte çështja e parë. Media është informim, liri, përfaqësim, demaskim.  
Gazetare S. XH





Ndoshta është çështje e cila mendohet të diskutohet pasi të jetë zgjidhur pjesmarrja në vendimmarrjen, çka do të pasonte me ndërgjegjshmëri më të madh edhe këtë temë.  
Gazetare E.A

Nuk duhet të presim që çdo problem që kemi ta adresojmë dhe ta zgjidhim të huajt. Pjesmarrja e grave në vendimmarrje do vijë gradualisht me një proces të vazhdueshëm ndërgjegjësimi dhe ndryshimi konceptesh për aftësitë mes gjinive. Gazetare: B.N

Gazetareve, që plotësuan pyetësin i'u kërkua të jepnin mendimin e tyre se çfarë mund të bëhet për të inkurajuar ndryshimet pozitive në lidhje me përfaqësimin e ulët të grave në rolet vendimmarrëse në media. Më poshtë keni tabelën me përgjigjet e pjesëmarrëseve në pyetësor:

Përmirësime në legjislacion	1	7.7%
Trajnime dhe fuqizim të grave	5	30.8
Ndërgjegjësim të drejtuesve të medias	6	46.2%
Promovim i punës së grave	1	15.4 %

Duke pasur sa më shumë gra në pozicionet drejtuese dhe vendimmarrëse në media ndikimi është pozitiv sepse gratë janë më të ndërgjegjshme, janë më të sakta edhe do të ketë më pak korrupsion mediatik, favorizim apo diskriminim gjinor.

Gruaja ka një botëkuptim më të butë në përgjithësi për gjithçka prandaj logjikisht programacionet do merrnin një tjetër formë, mesazhet që do tu përcillen audiencës do të jenë ato lloj mesazhesh për të cilat kjo shoqëri ka nevojë. Gazetare E.Q



Do të shihet si një pasqyrë ku vajzat e reja, gratë do të shohin histori suksesi nëpërmjet raporteve, spikereve, moderatoreve, pse jo edhe ato gra që punojnë pas kamerave. Media duhet të jetë pasqyrim, realitet dhe pse jo inspirim për çdo femër e grua. Gazetare nr10

Përmbajtjen mediatike dhe cilësinë e produkteve mediatike nuk e lidh fare me gjininë e atij që drejton një media. Gjinia është fundi që merret në konsideratë ose nuk konsiderohet fare. Unë do të ndikoja në politikat etike dhe editoriale duke i dhënë më shumë hapsirë dhe zë modeleve të suksesit të grave në fusha të ndryshme, apo grupeve të marginalizuara. Gazetare S. XH

Ajo çka bi në sy është se shumica e gazetarve të cilët ishin të përfshirë në pyetësor nuk kishin informacion mbi strategjinë e barazisë gjinore 2020-2030. Nga 13 gazetarë të përfshirë në pyetësor vetëm 2 prej tyre kishin informacion mbi strategjinë e barazisë gjinore 2020-2030. Të dhënat më specifike do ti paraqisim në tabelën e mëposhtme.

Po	2	15.4%
Jo	9	69.2%
Nuk e di	2	15.4%



## **Konkluzione**

Gratë dhe vajzat që plotësuan pyetësozin janë përgjithësisht të vetëdijshme për rolin e tyre në funksion të emancipimit të shoqërisë dhe të drejtave në bazë të meritokracisë. Ato kanë luftuar individualisht për të drejtat e tyre dhe janë munduar të fitojnë rolin e tyre në shoqëri nëpërmjet medias ku punojnë.

Ajo që bie në sy është një mungesë bashkëpunimi dhe mbështetjeje të gjinisë së njëjtë dhe vetëdijësimit se të drejtat janë natyrale dhe të panegociueshme.

Roli i gruas në media është disafish më ndikues se një profesion i zakonshëm pasi nëpërmjet imazhit, fjaëve, temave që trajtojnë, ato kanë vetinë të emancipojnë shoqërinë që u takojnë.

Nëpërmjet pyetësorit ato treguan se kanë nevojë për më tepër trajnime, për të marrë njohuri, për të zhvilluar aftësi dhe për tu vetëdijësuar, në rolin esencial në barazinë gjinore.

Nëpërmjet rrjeteve, trajnimeve, shkëmbimeve të ndryshme me vendet që kanë një traditë në arritjen e barazisë gjinore si dhe nëpërmjet fuqizimit të modeleve, vlerësimit të rolit dhe identifikimit të shembujve pozitiv do të ketë më shumë gra dhe vajza, të informuara, të fuqizuara dhe më të gatshme për të luftuar për të drejtat e tyre dhe për të drejtat e grave në komunitetin e gjerë.